

URDHËR
Nr. 456, datë 23.10.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Ardian Maçi, drejtor i përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, për një afat kohor, nga data 22.10.2018 deri në datën 28.10.2018.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Ardian Maçi.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi